



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

---

**PROJEKTLIGJI PËR KLASIFIKIMIN E INFORMATAVE DHE VERIFIKIMIN E SIGURISË**

**DRAFT LAW ON CLASSIFICATION OF INFORMATION AND SECURITY CLEARANCES**

**NACRT ZAKONA O KLASIFIKACIJI INFORMACIJA I VERIFIKACIJI BEZBEDNOSTI**



<b>REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI</b>	<b>REPUBLIC OF KOSOVO ASSEMBLY</b>	<b>REPUBLIKA KOSOVA SKUPŠTINA</b>
<p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>miraton</p>	<p>On the basis of article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>adopts</p>	<p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>usvaja</p>
<p><b>LIGJIN PËR KLASIFIKIMIN E INFORMATAVE DHE VERIFIKIMIN E SIGURISË</b></p>	<p><b>LAW ON CLASSIFICATION OF INFORMATION AND SECURITY CLEARANCES</b></p>	<p><b>ZAKONA O KLASIFIKACIJI INFORMACIJA I VERIFIKACIJI BEZBEDNOSTI</b></p>
<p><b>I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p>	<p><b>I. GENERAL PROVISIONS</b></p>	<p><b>I. OPŠTE ODREDBE</b></p>
<p><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i këtij ligji është themelimi i një sistemi unik për klasifikimin dhe ruajtjen e informatave që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë së Kosovës si dhe për verifikimin e sigurisë së personave që kanë qasje në këto informata.</p>	<p><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p> <p>The purpose of the present law is to establish a uniform system for classifying and safeguarding information related to Kosovo's security interests and for security clearances of all persons who have access thereto.</p>	<p><b>Član 1</b> <b>Cil Zakona</b></p> <p>Cilj ovog zakona je ustanovljavanje jedinstvenog sistema za klasifikaciju i čuvanje informacija koje su vezane za interese bezbednosti Kosova i verifikovanja bezbednosti lica koja imaju uvid u njih.</p>



<b>Neni 2 Fushëveprimi</b>	<b>Article 2 Scope of Application</b>	<b>Član 2 Delokrug</b>
<p>1. Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha institucioneve publike, përfshirë këtu Qeverinë, ministritë dhe agjencitë ekzekutive të qeverisë, si dhe institucionet tjera publike të degës së ekzekutivit, Kuvendin e Kosovës si dhe institucionet tjera publike të Kuvendit, Presidencën, komunat si dhe institucionet tjera publike të komunave, institucioneve të sigurisë të Kosovës, organeve të pavarura si dhe gjykatave dhe prokurorisë publike.</p> <p>2. Ky ligj zbatohet edhe ndaj shoqërive tregtare, organizatave jo-qeveritare dhe organizatave tjera të sektorit privat të cilat pranojnë apo në cilëndo formë tjetër kanë qasje në informata të klasifikuara dhe në informatat e klasifikuara të gjeneruara nga autoritetet publike si rezultat i një kontrate apo marrëveshjeje tjetër midis një institucioni publik dhe shoqërisë tregtare, organizatës joqeveritare apo çfarëdo organizate tjetër të sektorit privat.</p>	<p>1. The present law shall apply to all public authorities, including the government, government ministries and executive agencies and other public entities of the executive branch, the Assembly of Kosovo and other public bodies of the Assembly, the Presidency, municipalities and other public bodies of the municipalities, Kosovo's security institutions, independent bodies, the courts and the public prosecution.</p> <p>2 The present law shall also apply to business organizations, non-government organizations and other private sector organizations which receive or otherwise have access to classified information and to classified information generated by public authorities as a result of a contract or other arrangement between a public authority with a business organization, non-government organization or, respectively, any other private sector organization.</p>	<p>1. Ovaj zakon se primenjuje u svim javnim institucijama uključujući i Vladu, ministarstva i izvršne agencije Vlade, kao i druge javne institucije izvršnog ogranka, zatim Skupštinu Kosova, kao i ostale javne institucije Skupštine Predsedništvo, opštine , kao i ostale javne institucije u opštinama, instucije bezbednosti Kosova i u nezavisne organime, kai i sudove j javno tužilaštvo</p> <p>2. Ovaj zakon se primenjuje u trgovinskim društvima , nevladinim organizacijama i drugim organizacijama iz privatnog sektora koje primaju, odnosno imaju uvida u klasifikovane informacije i klasifikovanim informacijama proizvedenim od javnih agencija kao rezultat nekog ugovara ili drugih sporazuma između javnih autoritea i trgovačkog društva ili nevladinih organizacija ili bilo koje druge organizacije iz privatnog sektora.</p>



<b>Neni 3 Përkufizimet</b>	<b>Article 3 Definitions</b>	<b>Član 3 Definicije</b>
<p>1. Për qëllime të këtij ligji, shprehjet e mëposhtme kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>“Qasje”</b> nënkupton aftësinë apo mundësinë për të marrë njohuri rreth informatave të klasifikuara.</p> <p>1.2. <b>“Shoqëri Tregtare”</b> e ka kuptimin siç është definuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare nr. 02/L-123.</p> <p>1.3. <b>“Klasifikim”</b> nënkupton aktin apo procesin përmes të cilit informatat përcaktohen si informata të klasifikuara.</p> <p>1.4. <b>“Autoritet i Klasifikimit”</b> nënkupton çdo person i përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji që ka kompetencë origjinale apo të deleguar për të klasifikuar informata.</p> <p>1.5. <b>“Informatë e klasifikuar”</b> nënkupton çdo informatë dhe material, publikimi i paautorizuar i të cilave do të cenonte në shkallë të ndryshme interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës.</p>	<p>1. For the purposes of the present law the following terms shall have this meaning</p> <p>1.1. <b>“Access”</b> shall mean the ability or opportunity to gain knowledge of classified information.</p> <p>1.2. <b>“Business Organization”</b> shall have the meaning as defined in the Law on Business Organizations No. 02/L-123.</p> <p>1.3. <b>“Classification”</b> shall mean the act or process by which information is determined to be classified information.</p> <p>1.4. <b>“Classification Authority”</b> shall mean any person referred to in section 7 of the present law having original or delegated authority to classify information.</p> <p>1.5. <b>“Classified information”</b> shall mean any information and material, the unauthorized disclosure of which would cause varying degrees of prejudice to security interests of the Republic of Kosovo.</p>	<p>1. U svrhe ovog zakona dole navedeni izrazi imaju sledeće značenje :</p> <p>1.1. Pod <b>“Uvidom”</b> podrazumeva se sposobnost ili mogućnost za dobijanje saznanja o klasifikovanim informacijama.</p> <p>1.2. <b>“Trgovčko društvo”</b> ima značenje kako je definisano u Zakonu o Trgovačkim društvima br. 02/L-123</p> <p>1.3. Pod <b>“Klasifikacijom”</b> podrazmeva se akt ili proces preko kojeg se informacije utvrđuju kao klasifikovane informacije.</p> <p>1.4. <b>“Autoritet Klasifikacije”</b> podrazumeva svako lice o kome se govori u članu 7 ovog zakona, koje lice ima originalan ili prenet autoritet za klasifikaciju informacija</p> <p>1.5. Pod <b>“Klasifikovanim informacijama”</b> podrazumeva se svaka informaciju i materijal, čije bi neovlašćeno objavljivanje načkodilo, na raznim nivoima, interesima bezbednosti Republike Kosova</p>



<p>1.6. <b>“Kontratë e klasifikuar”</b> nënkupton çdo kontratë të lidhur nga një institucion publik që përmban informata të klasifikuara sipas këtij ligji.</p> <p>1.7. <b>“Deklasifikim”</b> nënkupton ndryshimin e autorizuar të statusit të informatave nga informatë e klasifikuar në informatë të paklasifikuar.</p> <p>1.8. <b>“Dokument”</b> nënkupton çdo mjet fizik apo elektronik mbi të cilin është regjistruar informata.</p> <p>1.9. <b>“Degradim”</b> nënkupton vendimin që informata e klasifikuar dhe e ruajtur në një nivel të përcaktuar klasifikohet dhe ruhet në nivel më të ulët klasifikimi.</p> <p>1.10. <b>“Informatë e Qeverisë së huaj”</b> nënkupton:</p> <p>1.10.1. informata e dhënë Republikës së Kosovës nga një qeveri e huaj apo organizatë qeveritare ndërkombëtare;</p> <p>1.10.2. informata e prodhuar nga</p>	<p>1.6. <b>“Classified contract”</b> shall mean any contract entered into by a public authority that contains information which are classified pursuant to the present law.</p> <p>1.7. <b>“Declassification”</b> shall mean the authorized change in the status of information from classified information to unclassified information.</p> <p>1.8. <b>“Document”</b> shall mean any physical and/or mening on which the information is recorded.</p> <p>1.9. <b>“Downgrading”</b> shall mean a decision that information classified and safeguarded at a specified level shall be classified and safeguarded at a lower level.</p> <p>1.10. <b>“Foreign government information”</b> shall mean</p> <p>1.10.1. information provided to the Republic of Kosovo by a foreign government or an international governmental organization;</p> <p>1.10.2. information produced by the</p>	<p>1.6 Pod <b>„Klasifikovanim ugovorom“</b> podrazumeva se svaki zaključeni ugovor od strane javne institucije koji sadrži klasifikovane informacije prema zakonu</p> <p>1.7. Pod <b>“Deklasifikacijom”</b> podrazumeva se ovlašćena izmena statusa informacija sa klasifikovane informacije na neklasifikovanu informaciju.</p> <p>1.8. Pod <b>“Dokumentom”</b> podrazumeva se svako fizičko ili elektronsko sredstvo na kojem je registrovana informacija</p> <p>1.9. Pod <b>“Degradacijom”</b> podrazumeva se odluka da će klasifikovana i očuvana informacija na utvrđenom nivou biti klasifikovana i očuvana na nižem nivou</p> <p>1.10. Pod <b>“Informacijom strane vlade”</b> podrazumeva se:</p> <p>1.10.1 Informacija data Republici Kosovo od neke strane vlade ili međunarodne vladine organizacije;</p> <p>1.10.2. Informacija proizvedena od</p>
--	--	---



<p>Republika e Kosovës në pajtim me, apo si rezultat i një marrëveshje të përbashkët me një qeveri të huaj apo organizatë qeveritare ndërkombëtare me pritjen apo kërkesën që një informatë, marrëveshje e tillë apo të dyja të mbahen sekret.</p> <p>1.11. <b>“Informatë”</b> nënkupton njohurinë që mund të komunikohet në çfarëdo forme.</p> <p>1.12. <b>“Material”</b> përfshinë dokumente si dhe çdo makineri, pajisje ose armatim që është prodhuar apo që është në prodhim e sipër.</p> <p>1.13. <b>“Përpunim”</b> nënkupton çdo veprim apo sërë veprimesh që bëhen ndaj të dhënave personale, me apo pa mjete automatike, siç është mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, adaptimi apo ndryshimi, kërkimi, konsultimi, shfrytëzimi, publikimi me transmetim, përhapja apo çdo formë tjetër e vënies në dispozicion, rreshtimit apo kombinimit, bllokimit, shlyerjes apo asgjësimit.</p> <p>1.14. <b>“Institucion publik”</b> përfshinë të</p>	<p>Republic of Kosovo pursuant to or as a result of a joint arrangement with a foreign government or international governmental organization with the expectation or requiring that such information, arrangement or both are to be held in confidence</p> <p>1.11. <b>“Information”</b> shall mean knowledge that can be communicated in any form.</p> <p>1.12. <b>“Material”</b> shall include documents as well as any machinery, equipment or weapons either manufactured or in the process of manufacture.</p> <p>1.13. <b>“Processing”</b> shall mean any operation or set of operations which is performed upon personal data, whether or not by automatic means, such as collection, recording, organization, storage, adaptation or alteration, retrieval, consultation, use, disclosure by transmission, dissemination or otherwise making available, alignment or combination, blocking, erasure or destruction.</p> <p>1.14. <b>“Public authority”</b> shall</p>	<p>strane Republike Kosova u skladu sa, ili kao rezultat nekog zajedničkog sporazuma sa nekom stranom vladom ili medjunarodnom vladinim organizacijom uz očekivanje ili zahtev da će se takva informacija ili takav sporazum, ili oba njih, držati u tajnosti (poverenju).</p> <p>1.11. Pod <b>“Informacijom”</b> podrazumeva se saznanje koje se može saopštiti u svakom obliku.</p> <p>1.12. Pod <b>“Materialom”</b> podrazumevaju se dokumenti i svaka mašinerija, oprema oružja, koja je proizvedea ili koji je u toku proizvodnje.</p> <p>1.13. Pod <b>“Obradom”</b> podrazumeva se svaki postupak ili niz postupaka koji se čine prema ličnim podacima: ličnim podacima, automatskim ili neautomatskim sredstvima, kao što je prikupljanje, snimanje, organizovanje, očuvanje, adaptacija ili izmena, traženje, konsultacija, korišćenje, publikovanje prenosom, širenje ili stavljanje na raspolaganje, svrstavanje ili kombinovanje, blokiranje, brisanje ili uništenje.</p> <p>1.14. <b>“Javna institucija”</b> obuhvata sve</p>
---	--	---



<p>gjitha institucionet dhe organet e përcaktuara në nenin 2.1 të këtij ligji.</p> <p>1.15. <b>“Interesat e sigurisë”</b> i referohet mbrojtjes, veprimtarive të zbatimit të ligjit dhe zbulimit, marrëdhënieve me jashtë apo të sigurisë të Republikës së Kosovës, përfshirë integritetin e saj territorial, integritetin e institucioneve të saja, rregullin kushtetues si dhe stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik.</p> <p>1.16. <b>“Bashkëshort/e”</b> nënkupton çdo marrëdhënie të krijuar përmes martesës së ligjshme dhe për nevojat e këtij ligji përfshinë edhe çdo marrëdhënie jashtëmartesore midis dy personave fizikë.</p> <p>1.17. <b>“Agjenci”</b> nënkupton Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.</p> <p>1.18 <b>“Drejtues i institucionit publik”</b> për nevojat e këtij ligji nënkupton zyrtarin më të lartë të Shërbimit Civil të një organi publik në nivelin e Sekretarit të Përhershëm, Shefit Ekzekutiv apo cilësdjo pozitë tjetër të barazvlefshme me këto.</p>	<p>include all institutions and entities referred to in section 2.1 of the present law.</p> <p>1.15. <b>“Security interests”</b> shall refer to defense, intelligence and law enforcement activities, security or foreign relations of the Republic of Kosovo, including its territorial integrity, integrity of its institutions, the constitutional order and economic stability and development.</p> <p>1.16. <b>“Spouse”</b> shall mean any relationship established by lawful marriage and shall include for the purposes of the present law any extramarital relationship between two physical persons</p> <p>1.17. <b>“Agency”</b> shall mean the Kosovo Intelligence Agency.</p> <p>1.18. <b>“Head of a public authority”</b> shall mean for the purposes of the present law the highest civil servant of a public authority at the level of a Permanent Secretary, Chief Executive Officer or any other equivalent position.</p>	<p>institucije i organe utvrđenih u delu 2.1 ovog zakona</p> <p>1.15. Pod <b>“Interesima bezbednosti”</b> podrazumeva se zaštita, obaveštajne delatnosti, spoljni ili bezbednosni odnosi Republike Kosova, uključujući njen teritorijalni integritet, integritet njenih institucija, ustavno uređenje kao i stabilnost i ekonomski razvoj.</p> <p>1.16. <b>“Suprug/a”</b> podrazumeva svaki odnos nastao putem zakonitog braka a za potrebe ovog zakona obuhvata i svaki vanbračni odnos između dva fizička lica .</p> <p>1.17. <b>“Agencija”</b> podrazumeva Kosovsku obaveštajnu agenciju</p> <p>1.18. <b>“Pod “Rukovodiocm javne institucije”</b>, za potrebe ovog zakona podrazumeva se najviši zvaničnik Civilne službe javnog organa na nivo Stalnog sekretara, Izvršnog načelnika ili bilo kog drugog položaja ekvivalentnog njima</p>
--	---	---



<b>II. KLASIFIKIMI I INFORMATAVE</b>	<b>II. CLASSIFICATION OF INFORMATION</b>	<b>II. KLASIFIKACIJA INFORMACIJA</b>
<p data-bbox="302 428 606 493" style="text-align: center;"><b>Neni 4 Kriteret e Klasifikimit</b></p> <p data-bbox="180 537 726 602">1. Informatat klasifikohen vetëm nëse është e nevojshme dhe nëse</p> <p data-bbox="212 646 726 751">1.1. klasifikimi bëhet nga autoriteti kompetent i klasifikimit siç është përcaktuar me këtë ligj;</p> <p data-bbox="212 792 726 898">1.2. informatat zotërohen, prodhohen nga apo për, ose janë nën kontroll të Republikës së Kosovës;</p> <p data-bbox="212 938 726 1008">1.3. informatat bien brenda një apo më shumë prej këtyre kategorive:</p> <ul data-bbox="260 1049 726 1372" style="list-style-type: none"><li>1.3.1. siguri publike;</li><li>1.3.2. mbrojtje, plane ushtarake, sisteme armësh, apo operacione;</li><li>1.3.3. informata për marrëdhëniet me jashtë dhe qeveritë e jashtme, përfshirë burimet konfidenciale;</li><li>1.3.4. veprimtari zbulimi dhe të zbatimit të ligjit, përfshirë metoda dhe burime të zbulimit;</li></ul>	<p data-bbox="856 428 1220 493" style="text-align: center;"><b>Article 4 Classification Criteria</b></p> <p data-bbox="747 537 1329 602">1. Information shall be classified only if necessary and if</p> <p data-bbox="779 646 1329 751">1.1. the classification is conducted by a competent Classification Authority as determined in the present law;</p> <p data-bbox="779 792 1329 898">1.2. the information is owned by, produced by or for, or is under the control of the Republic of Kosovo;</p> <p data-bbox="779 938 1329 1008">1.3. the information falls within one or more of the following categories:</p> <ul data-bbox="827 1049 1329 1372" style="list-style-type: none"><li>1.3.1. public security;</li><li>1.3.2. defense, military plans, weapons systems, or operations;</li><li>1.3.3. foreign relations and foreign government information, including confidential sources;</li><li>1.3.4. intelligence and law enforcement activities, including intelligence methods and sources;</li></ul>	<p data-bbox="1444 428 1818 493" style="text-align: center;"><b>Član 4 Kriterijumi za klasifikaciju</b></p> <p data-bbox="1350 537 1911 602">1. Informacije mogu se klasifikovati samo ako je potrebno i ako se</p> <p data-bbox="1381 646 1911 751">1.1. klaisifikacija obavlja od strane nadležnog autoriteta za klasifikaciju kao što je utvrđeno ovim zakonom;</p> <p data-bbox="1381 792 1911 898">1.2. informacije se poseduju, proizvode od ili za, ili su pod kontrolom Republike Kosova;</p> <p data-bbox="1381 938 1911 1008">1.3. informacije spadaju u okviru jedne ili više od sledećih kategorija:</p> <ul data-bbox="1430 1049 1911 1372" style="list-style-type: none"><li>1.3.1. javna bezbednost;</li><li>1.3.2. zaštita, vojni planovi, sistemi oružja ili operacije;</li><li>1.3.3. informacije o odnosima sa inostranstvom i stranim vladama, uključujući povrljive izvore;</li><li>1.3.4. obaveštajna delatnost, uključujući obaveštajne metode i izvore;</li></ul>





<p>1.3.5. sisteme, instalime, infrastruktura, projekte, plane apo shërbime të mbrojtjes që lidhen me interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3.6. veprimtari shkencore, teknologjike, ekonomike, financiare që lidhen me interesat thelbësore të sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.4. Autoriteti i Klasifikimit përcakton që informata është aq e rëndësishme sa që publikimi i saj i paautorizuar për apo nga personat e paautorizuar do t'i dëmtojë interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Klasifikimi i Ndaluar</b></p> <p>1. Nuk lejohet klasifikimi i informatave për të:</p> <p>1.1. fshehur shkeljet e ligjit, abuzimin e autoritetit, mosefikasitetin apo gabimin administrativ;</p> <p>1.2. parandaluar turpërimin e një personi, autoriteti publik apo organizate;</p>	<p>1.3.5 systems, installations, infrastructures, projects, plans or protection services relating to security interests of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3.6 scientific, technological, economic, financial activities relating to security interests of the Republic of Kosovo; and</p> <p>1.4 the Classification Authority determines that the information is so important that its unauthorized disclosure to or by unauthorized persons would damage security interests of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Prohibited Classification</b></p> <p>1. Information shall not be classified to</p> <p>1.1 conceal violations of law, abuse of authority, inefficiency or administrative error;</p> <p>1.2 prevent embarrassment to a person, public authority or organization;</p>	<p>1.3.5. sistemi, instalacije, infrastrukture, projekti, planovi ili službe za odbranu koje su povezane sa interesima bezbednosti Republike Kosovo;</p> <p>1.3.6. naučne, tehnološke, ekonomske, finansijske koje su povezane sa suštinskim interesima bezbednosti Republike Kosovo;</p> <p>1.4. Autoritet za klasifikaciju utvrđuje da je informacija toliko važna da bi njeno neovlašćeno objavljivanje/širenje za ili od neovlašćenih lica oštetilo interese bezbednosti Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Zabranjena klasifikacija</b></p> <p>1. Informacije se ne klasifikuju da bi:</p> <p>1.1. sakrivale kršenje zakona, zloupotrebu autoriteta, neefikasnost ili administrativnu grešku;</p> <p>1.2. sprečavale sramoćenje nekog lica, agencije ili organizacije;</p>
--	---	--



<p>1.3. ndaluar konkurrencën; apo</p> <p>1.4. parandaluar apo vonuar publikimin e një informate, e cila qartazi nuk ka të bëjë me çështje të sigurisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Nivelet e Klasifikimit</b></p> <p>1. Informata mund të klasifikohet në njërin nga këto nivele:</p> <p>1.1. “TEPËR SEKRET”, zbatohet për informatat, hapja e paautorizuar e të cilave sipas vlerësimit të arsyeshëm do të shkaktonte dëm jashtëzakonisht të rëndë për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. “SEKRET”, zbatohet për informatat, hapja e paautorizuar e të cilave do t’i dëmtonte seriozisht interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. “KONFIDENCIALE”, zbatohet për informatat, hapja e paautorizuar e të cilave do të mund t’i dëmtonte interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;</p>	<p>1.3 restrain competition; or</p> <p>1.4 prevent or delay the release of information, which is not clearly related to security.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Classification Levels</b></p> <p>1. Information may be classified at one of the following levels:</p> <p>1.1 “TOP SECRET” shall be applied to information the unauthorized disclosure of which reasonably could be expected to cause exceptionally grave damage to security interests of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. “SECRET” shall be applied to information the unauthorized disclosure of which could seriously damage security interests of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. “CONFIDENTIAL” shall be applied to information the unauthorized disclosure of which could damage security interests of the Republic of</p>	<p>1.3. zabranile konkurenciju; ili</p> <p>1.4. sprečavale ili odložile izdavanje informacije koja nije jasno vezana za bezbednost.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Nivoi klasifikacije</b></p> <p>1. Autoritet za klasifikacije može klasifikovati informacije na jednom od sledećih nivoa:</p> <p>1.1. “STROGA TAJNA”, koja se primenjuje za informacije, čije bi neovlašćeno otvaranje s razlogom moglo očekivati da će naneti vrlo tešku štetu interesima bezbednosti Republike Kosova;</p> <p>1.2. “TAJNA”, koja se primenjuje za informacije čije bi neovlašćeno otvaranje ozbiljno štetilo interesima bezbednosti Republike Kosovo;</p> <p>1.3. “POVERLJIVO”, koje se primenjuje za informacije čije bi neovlašćeno otvaranje štetilo interesima bezbednosti Republike</p>
--	---	---



<p>1.4. “E KUFIZUAR”, zbatohet për informatat, hapja e paautorizuar e të cilave do të ishte e pafavorshme për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Kompetenca për Klasifikim</b></p> <p>1. Pavarësisht nga paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7, kompetencën për klasifikim e ka vetëm institucioni publik i cili e ka prodhuar informatën.</p> <p>2. Kompetencën origjinale për klasifikim në nivelin “TEPËR SEKRET” e kanë:</p> <p>2.1. Presidenti i Kosovës,</p> <p>2.2. Kryetari i Kuvendit të Kosovës,</p> <p>2.3. Kryeministri,</p> <p>2.4. Ministrat;</p> <p>2.5. Kryesuesi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës;</p>	<p>Kosovo;</p> <p>1.4. “RESTRICTED” shall be applied to information the unauthorized disclosure of which could be disadvantageous to the interests of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Classification Authority</b></p> <p>1. Notwithstanding articles 7.2 and 7.3, classification authority shall be vested solely in the originator of the information.</p> <p>2. “TOP SECRET” original classification authority may be exercised only by:</p> <p>2.1. the President of Kosovo,</p> <p>2.2. the President of the Assembly of Kosovo,</p> <p>2.3. the Prime Minister,</p> <p>2.4. Ministers;</p> <p>2.5. the Chair of the Kosovo Security Council;</p>	<p>Kosovo;</p> <p>1.4. “OGRANIČENO”, koje se primenjuje za informacije čije bi neovlašćeno otvaranje bilo štetno po interesima bezb ednosti Republike Kosova;</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Autoriteti za klasifikaciju</b></p> <p>1. Nezavisno od stavova 2. i 3. člana 6. nadležnost za klasifikaciju ima samo javna institucija koja je proizvela informaciju</p> <p>2. Originalnu nadležnost za klasifikaciju na nivou “STROGA TAJNA” imaju:</p> <p>2.1. Predsednik Kosova,</p> <p>2.2. Predsednik Skupštine Kosova,</p> <p>2.3. Premijer</p> <p>2.4. Ministri ;</p> <p>2.5. Predsedavajući Saveta bezbednosti Kosova.</p>
---	---	--



<p>2.6. Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;</p> <p>2.7. Drejtori Gjeneral i Policisë së Kosovës;</p> <p>2.8. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës;</p> <p>2.9. Udhëheqësit apo bordet udhëheqëse të organeve të pavarura.</p> <p>3. Personat e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 7 kanë të drejtë që t'ia delegojnë kompetencën për klasifikim vartësve të tyre të drejtpërdrejt.</p> <p>4. Kompetencën origjinale të klasifikimit në nivelin “SEKRET”, “KONFIDENCIALE” dhe “E KUFIZUAR” e kanë Sekretarët e Përhershëm, Kryeshefat Ekzekutivë apo Drejtorët Ekzekutivë të institucioneve publike dhe pozicionet e barasvlershme me ta, përveç nëse ata ia delegojnë këtë kompetencë zyrtarëve të lartë vartës.</p> <p>5. Zyrtarët e autorizuar për klasifikimin e informatave në një nivel të përcaktuar kanë të drejtë t'i klasifikojnë</p>	<p>2.6. the Director of the Kosovo Intelligence Agency;</p> <p>2.7. the Director General of the Kosovo Police;</p> <p>2.8. the Commander of the Kosovo Security Force</p> <p>2.9. Heads of governing boards of independent bodies.</p> <p>3. The persons listed in pragraph 2 of Article 7 may delegate their classification authority to their direct subordinate officials.</p> <p>4. “SECRET”, “CONFIDENTIAL” and “RESTRICTED” original classification authority may be exercised only by Permanent Secretaries, Chief Executive Officers or Executive Directors of public authorities and other equivalent senior positions, unless they delegate such classification authority to subordinate senior officials.</p> <p>5. Officials authorized to classify information at a specified level shall also be authorized to classify information at a lower</p>	<p>2.6. Direktor Obaveštajne agencije Kosova</p> <p>2.7. Generalni direktor Kosovske policije</p> <p>2.8. Komandant Bezbednosnih snaga Kosova</p> <p>2.9. Rukovodilaca ili rukovodećih bordova nezavisnih organa, samo ako su oni preneli autoritet klasifikacije podčinjenim službenicima.</p> <p>3. Lica utvrdjena u stavu 2 člana 7 imaju pravo preneti nadležnost za klasifikaciju njihovim neposrednim podređenima</p> <p>4. Originalnu nadležnost za klasifikaciju na nivou “TAJNA”, “POVRLJIVO” i “OGRANIČENO” imaju stalni sekretari, izvršni načelnici ili izvršni direktori javnih institucija i položajji ekvivalentni njima , osim ako oni ovu nadležnost prenose visokim podređenim zvaničnicima</p> <p>5. Službenici ovlašćeni za klasiifikaciju informacija na utvrdjenom nivou takodje se ovlašćuju da klasifikuju</p>
---	--	--



<p>informatat edhe në nivel më të ulët.</p> <p>6. Delegimi i kompetencës për klasifikim kufizohet në minimumin e kërkuar për ta zbatuar këtë ligj. Institucionet publike të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 4 të nenit 7, janë përgjegjës që të sigurojnë se çdo delegim i kompetencës për klasifikim të zyrtarët vartës revokohet nëse nuk ka nevojë të qartë dhe të vazhdueshme që zyrtarët të ushtrojnë kompetencë të tillë klasifikimi. Kompetenca për klasifikim e deleguar të zyrtarët në pajtim me paragrafët 2 dhe 4 të nenit 7 nuk i delegohet më tutje ndonjë personi tjetër.</p> <p>7. Çdo delegim i kompetencës për klasifikim bëhet me shkrim dhe e identifikon qartë zyrtarin me emër dhe titull të pozitës.</p> <p>8. Agjencia harton, mirëmbanë dhe rregullisht e azhuron një listë me emrat e zyrtarëve që kanë kompetencë klasifikimi në nivelet “TEPËR SEKRET” dhe “SEKRET”.</p> <p>9. Kur një zyrtar, punonjës apo kontraktues i një institucioni publik, që nuk ka kompetencë origjinale apo të</p>	<p>level.</p> <p>6. Delegations of classification authority shall be limited to the minimum required to implement the present law. Authorities referred to articles 7.2 and 7.4 shall be responsible for ensuring that any delegation of classification authority to subordinate officials is withdrawn if there is no demonstrable and continuing need for the officials to exercise such classification authority. Classification authority delegated to officials pursuant to articles 7.2 and 7.4 shall not be sub-delegated to any other person.</p> <p>7. Each delegation of classification authority shall be in writing and shall identify the official clearly by name and position title.</p> <p>8. The Agency shall establish, maintain and regularly update a list of officials with “TOP SECRET” and “SECRET” classification authority.</p> <p>9. When an official, employee or contractor of a public authority, who does not have original or delegated classification</p>	<p>informacije nižeg nivoa.</p> <p>6. Prenošenje nadležnosti za klasifikaciju je ograničeno na zatraženi minimum za sprovođenje ovog zakona. Javne institucije utvrđene u u stavovima 2. i 4. člana 7. odgovorni su da garantuju da će svako prenošenje nadležnosti za klasifikaciju na podređne službenike biti povučeno ako nema dokazane i stalne potrebe da službenici vrše takav autoritet klasifikacije. Nadležnost za klasifikaciju koje je preneto na službenike u skladu sa stavovima 2. i 4. člana 7. ne može se dalje preneti nekom drugom licu.</p> <p>7. Svako prenošenje nadležnosti za klasifikaciju vrši se pismeno i jasno identifikuje službenika po imenu i nazivu položaja.</p> <p>8. Bezbednosna agencija Kosova izradjuje, održava i redovno ažurira spisak sa imenima zvaničnika sa autoritetom za klasifikaciju “STROGA TAJNA” i “TAJNA”.</p> <p>9. Kada neki zvaničnik, radnik ili ugovorać neke javne institucije koja nema originalnu ili prenetu nadležnost za</p>
--	---	--



<p>deleguar për klasifikim, prodhon një informatë, e cila sipas mendimit të atij personi kërkon klasifikim, ai/ajo e mbronë atë informatë në mënyrën e paraparë me këtë ligj dhe menjëherë ia transmeton informatën zyrtarit, i cili e ka kompetencën e duhur për klasifikim dhe që është përgjegjës për çështjen. Personi me kompetencë për klasifikim dhe përgjegjësi vendosë brenda 30 ditësh nëse kjo informatë duhet klasifikuar.</p>	<p>authority, originates information, which in the opinion of that person requires classification, he/she shall protect such information in a manner consistent with the present law and immediately transmit the information to the official, which has appropriate classification authority and responsibility for the subject-matter. The person with classification authority and responsibility shall decide within 30 days whether to classify this information.</p>	<p>klasifikaciju, donese informaciju, koja po mišljenju tog lica zahteva klasifikaciju, on/ona štiti tu informaciju u skladu sa ovim zakonom i odmah prenosi informaciju službeniku koji ima odgovarajuću nadležnost za klasifikaciju i odgovornost za to pitanje. Lice nadležno za klasifikaciju i koje je odgovorno, u roku od 30. dana odlučuje da li ovu informaciju treba klasifikovati.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Vendimi për Klasifikim</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Classification Decision</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Odluka o klasifikaciji</b></p>
<p>1. Autoriteti i Klasifikimit vendosë nëse informata duhet klasifikuar dhe përcakton nivelin e klasifikimit të informatës që në momentin kur informata prodhohet.</p> <p>2. Vendimi nëse duhet klasifikuar informata dhe përcaktimi i nivelit të klasifikimit bazohet në një vlerësim të pasojave të dëmshme që mund të rezultojnë për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës nga hapja e paautorizuar e informatës së tillë. Vlerësimi bëhet me shkrim dhe i bashkëngjitet si shtojcë dokumentit që</p>	<p>1. A Classification Authority shall decide whether to classify information and determine the classification level of the information as of the moment when the information is originated.</p> <p>2. The decision whether to classify information and its level of classification shall be based on an evaluation of the possible harmful effects of unauthorized disclosure of such information to the security interests of the Republic of Kosovo. The evaluation shall be in writing and shall be attached as an annex to the document, which contains the classified information.</p>	<p>1. Autoritet za klasifikaciju odlučuje da li informacija treba biti klasifikovana i utvrđuje nivo klasifikacije informacije još od trenutka kada se informacija sastavlja.</p> <p>2. Odluka o tome da li treba klasifikovati informaciju i utvrđivanje njenog nivoa zasniva se na proceni mogućnosti štetnog učinka po interesima bezbednosti Republike Kosova neovlašćenim otvaranjem takve informacije. Procena se vrši pismeno i prilaže se kao dodatak dokumentu koji sadrži klasifikovanu informaciju.</p>



<p>përmbanë informatën e klasifikuar.</p> <p>3. Autoriteti i Klasifikimit i shmanget klasifikimit të tepërt të informatave dhe atyre u cakton vetëm nivel të tillë të klasifikimit që është i nevojshëm për ta ruajtur interesat e Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Klasifikimi i Pjesëve të Dokumenteve dhe të Dokumenteve të Ndara</b></p> <p>1. Faqe të caktuara, paragrafë, pjesë, shtojca, bashkëngjitje dhe materiale të bashkëmbyllura të një dokumenti të caktuar, që kërkojnë klasifikime të ndryshme, shënjohen sipas klasifikimit të vet. Klasifikimi i dokumentit si tërësi bëhet në nivelin më të lartë të klasifikimit që e kanë pjesët e tij.</p> <p>2. Klasifikimi i një letre apo shënimi që mbulon materialet e bashkëngjitura është aq i lartë sa niveli më i lartë i klasifikimit të materialit të tij të bashkëngjitur. Autoriteti i Klasifikimit tregon qartë se në çfarë niveli duhet klasifikuar letra apo shënimi nëse shkëputet nga materiali i bashkëmbyllur.</p>	<p>3. A Classification Authority shall avoid over-classification of information and shall assign to information only such classification level that is necessary to safeguard the interests of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Classification of parts of a document and of separate documents</b></p> <p>1. Individual pages, paragraphs, sections, annexes, appendices, attachments and enclosures of a given document, which require different classifications, shall be marked accordingly. The classification of the document as a whole shall be that of the most highly classified part.</p> <p>2. The classification of a letter or a note covering enclosures shall be as high as the highest classification level of its enclosures. The Classification Authority shall indicate clearly at which level the letter or note should be classified if detached from its enclosures.</p>	<p>3. Autoritet za klasifikaciju izbegava prekomernu klasifikaciju informacija tako da njima odredjuje samo takav nivo informacija koji je potreban za zaštitu interesa Republike Kosova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Klasifikovanje delova dokumenata i odvojenih dokumenata</b></p> <p>1. Odredjene strane, stavovi, delovi, aneksi, prilozi i zajedno zatvoreni materiali odredjenog dokumenta za koje se traže razne klasifikacije označavaju se na takav način. Klasifikacija dokumenta kao celine je ona iz dela klasifikovanog na viši nivo.</p> <p>2. Klasifikacija nekog pisma ili beleške koja pokriva priložene materijale je isto toliko visoka koliko i najviši nivo klasifikacije njenog priloženog materijala. Autoritet klasifikacije jasno naznačuje na kom nivou treba klasifikovati pismo ili belešku ako se izdvoji iz materijala koji je zajedno zatvaran.</p>
--	---	---



<p>3. Autoriteti i Klasifikimit mund t'i klasifikojë informatat që gjenden në dokumente të ndara, që në mënyrë të ndarë nuk konsiderohen se kërkojnë klasifikim, por që kur kombinohen si tërësi kërkojnë mbrojtje nga hapja e paautorizuar.</p>	<p>3. A Classification Authority may classify information contained in separate documents, which separately are not considered to require classification, but which when combined as a whole require protection from unauthorized disclosure.</p>	<p>3. Autoriteti i klasifikimit mund të klasifikojë informacione të ndara, të cilat në mënyrë të ndarë nuk konsiderohen se kërkojnë klasifikim, por që kur kombinohen si tërësi kërkojnë mbrojtje nga hapja e paautorizuar.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10 Shënjimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10 Marking</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10 Obeležavanje</b></p>
<p>1. Të gjitha dokumentet që përmbajnë informata të klasifikuara, në ballinë mbajnë këtë shënjim:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1. Nivelin e klasifikimit;</li><li>1.2. Datën e klasifikimit</li><li>1.3. Emrin dhe titullin e pozitës së autoritetit të klasifikimit;</li><li>1.4. Institucionin publik të prejardhjes;</li><li>1.5. Listën e shpërndarjes, nëse ka; dhe</li><li>1.6. Informata mbi deklasifikimin.</li></ul>	<p>1. All documents containing classified information shall on their face have the following marking:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1. Classification level;</li><li>1.2. Date of classification</li><li>1.3. Name and position title of the Classification authority;</li><li>1.4. Public authority of origin;</li><li>1.5. Distribution list, if any; and</li><li>1.6. Declassification information.</li></ul>	<p>1. Sva dokumenta koja sadrže klasifikovane informacije, na naslovnoj strani sadrže znak:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1. Nivo klasifikacije;</li><li>1.2. Datum klasifikacije;</li><li>1.3. Ime i zvanje pozicije autoriteta klasifikacije;</li><li>1.4. Javnu instituciju porekla</li><li>1.5. Spisak distribucije, ako postoji,</li><li>1.6. Informacije o deklasifikaciji.</li></ul>
<p>2. Shënjimet aplikohen si në vijim:</p>	<p>2. Markings shall be applied as follows:</p>	<p>2. Obeležavanja primenjuju se i to:</p>





<p>2.1. mbi dokumentet “E KUFIZUARA”, me mjete mekanike apo elektronike;</p> <p>2.2. mbi dokumentet “KONFIDENCIALE”, me mjete mekanike dhe me dorë apo duke shtypur mbi letrën e regjistruar të vulosur që përpara;</p> <p>2.3. mbi dokumentet e “SEKRET” dhe “TEPËR SEKRET”, me mjete mekanike dhe me dorë.</p> <p>3. Nëse nuk është parashikuar ndryshe me traktat, në të cilin Republika e Kosovës është palë, apo me ndonjë instrument tjetër ndërkombëtar të detyrueshëm, shënjimi i një dokumenti të një qeverie të huaj apo organizate ndërkombëtare që përmban informata të klasifikuara mbanë shënjimet origjinale të klasifikimit apo mund t’i caktohet klasifikim sipas legjislacionit të Kosovës që parasheh shkallën e mbrojtjes të paktën të barabartë me atë që kërkohet nga institucioni që ka sjellë informatën.</p>	<p>2.1 on “RESTRICTED” documents, by mechanical or electronic means;</p> <p>2.2 on “CONFIDENTIAL” documents, by mechanical means and by hand or by printing on pre-stamped, registered paper;</p> <p>2.3 on “SECRET” and “TOP SECRET” documents, by mechanical means and by hand.</p> <p>3. Unless otherwise provided by treaty, to which the Republic of Kosovo is a party, or any other binding international instrument, the marking of a document of a foreign government or international organization containing classified information shall retain its original classification markings or may be assigned classification under Kosovo legislation that provides a degree of protection at least equivalent to that required by the entity that furnished the information.</p>	<p>2.1. za dokumente “OGRANIČENO”, mehničkim ili elektronskim sredstvima;</p> <p>2.2. za dokumente “POVERLJIVO”, mehničkim ili ručnim sredstvima ili štampajući na registrovanom papiru unapred zapečaćenog.</p> <p>2.3. za dokumente “TAJNA” i “STROGA TAJNA”, mehničkim sredstvima ili ručno.</p> <p>3. Ako nije drugačije predviđeno pismenim sporazumom, u kome je Republika Kosovo strana, ili nekim drugim obavezujućim međunarodnim instrumentom obeležavanje nekog dokumenta strane vlade ili međunarodne organizacije koji sadrži klasifikovane informacije sadržeće originalne oznake klasifikacije ili se može odrediti kao klasifikacija na Kosovu koja predviđa stepen zaštite, najmanje jednak sa onim koji se traži od entiteta koje je doneo informaciju.</p>
---	--	---



<b>Neni 11 Kohëzgjatja e Klasifikimit</b>	<b>Article 11 Duration of Classification</b>	<b>Član 11 Vreme trajanja klasifikacije</b>
<p>1. Informata qëndron e klasifikuar vetëm gjersa kërkon mbrojtje. Përveç nëse Autoriteti i Klasifikimit e ka caktuar një datë ose ngjarje të veçantë për deklasifikim duke marrë parasysh kohëzgjatjen e ndjeshmërisë së informatës afatet në vijim vlejné për deklasifikim automatik:</p> <p>1.1. informatat e klasifikuara si “TË KUFIZUARA” deklasifikohen 1 vit pas datës së vendimit për klasifikim;</p> <p>1.2. informatat e klasifikuara si “KONFIDENCIALE” deklasifikohen 5 vite pas datës së vendimit për klasifikim;</p> <p>1.3. informatat e klasifikuara si “SEKRET” deklasifikohen 15 vite pas datës së vendimit për klasifikim; dhe</p> <p>1.4. informatat e klasifikuara si “TEPËR SEKRET” deklasifikohen 25 vite pas datës së vendimit për klasifikim.</p> <p>2. Në rast se Autoriteti Klasifikues</p>	<p>1. Information shall remain classified only as long as it requires protection. Unless the Classification Authority has established a specific date or event for declassification taking into account the duration of the sensitivity of the information the following timelines shall apply for automatic declassification:</p> <p>1.1. information classified as “RESTRICTED” shall be declassified 1 year from the date of the classification decision;</p> <p>1.2. information classified as “CONFIDENTIAL” shall be declassified 5 years from the date of the classification decision</p> <p>1.3. information classified as “SECRET” shall be declassified 15 years from the date of the classification decision; and</p> <p>1.4. information classified as “TOP SECRET” shall be declassified 25 years from the date of the classification decision.</p> <p>2. In the event that the Classification</p>	<p>1. Informacija ostaje klasifikovana samo dok traži zaštitu. Osim ako je autoritet za klasifikaciju odredio datum ili određen događaj za deklasifikaciju uzimajući u obzir vreme trajanja osetljivosti informacija. Ščedeči rokovi važe samo za automastku deklasifikacij:</p> <p>1.1. klasifikovane informacije kao “OGRANIČENE” deklasifikuju se jednu godinu nakon dana odluke o klasifikaciji;</p> <p>1.2. klasifikovane informacije kao “POVERLJIVE” deklasifikuju se pet godina nakon dana o klasifikaciji;</p> <p>1.3. klasifikovane informacije kao “TAJNE” deklasifikuju se 15. godina nakon datuma odluke o klasifikaciji; i</p> <p>1.4. klasifikovane informacije kao “STROGO TAJNE” deklasifikuju se 25. godina nakon datuma odluke o klasifikaciji.</p> <p>2. U slučaju da autoritet za klasifikaciju</p>



